

Syllabusi i lëndës

Lënda: Islami dhe pluralizmi fetar – perceptimi musliman i “feve tjera”

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 5

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 101

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: I

Mësimdhënësi: Prof. dr. Milazim Krasniqi

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Studimi dhe perceptimi i “feve tjera” nga aspekti i myslimanit përfshinë, vecmas Hebraizmin dhe Krishterimin si fe me origjinë hyjnore, që i përkasin së bashku me islamin feve Ibrahimike. Fokusimi do të jetë në esencën e eksperiencës religjioze në Judaizëm dhe Krishterizem. Madje elaborimin e burimet e tyre, historikun e strukturimit, llojet, karakteristikat si interpretimin e tyre, si dhe formimin e teologjisë dhe ndarjes së tyre. Pastaj roli i agnosticizmit dhe helenizmit dhe ndikimin në formimin e sekteve, rëndësinë e tyre në jetën e përditshme dhe dobinë e njohjes se këtyre feve për bashkëjetesën dhe paqen mes religjioneve më të mëdha të botës.

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lënde është që të përçojë sa më qartë te studenti historikun dhe zhvillimi e këtyre religjioneve, burimin, dhe karakteristikat e tyre të përbashkëta dhe specifikeve të tyre me islamin dhe të tjerat mes veti. Po ashtu t’i shpjegojë atij sa më hollësisht saktësinë e tyre nga këndvështrimi i brendshëm i një hebreu apo te krishteri dhe nga ai i jashtëm i një muslimani, dhe historikun e zhvillimit dhe ndërhyrjes. Me këtë studim synohet që studenti të marrë njohuri të detajuara rreth këtyre religjioneve, esencës së tyre, zhvillimit dhe përvojës së tyre religjioze në kultivimin e tolerancës dhe bashkëjetesës mes religjioneve të mëdha. Gjithashtu synohet që studenti të jetë sa më i saktë në përcjelljen e

kësaj njohurie të tjerët, duke informuar dhe vetëdijesuar shoqërinë për rëndësinë e këtyre religjioneve dhe sidomos në zhvillimin e tolerancës dhe harmonisë ndërfetare.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:

Të njoh dhe përshkruajë esencën e këtyre dy religjioneve

Të krahasojë këto dy religjione njëra me tjetrën

Të krahasojë këto dy religjione me islamin

Të përshkruajë historikun e zhvillimit të këtyre dy religjioneve dhe për rrjedhojë edhe zhvillimin e teologjisë dhe përvojës së tyre fetare.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilit prej tyre, duke ia parashtruar argumentet përkatëse.

Të jetë në gjendje që me njohuritë e fituara të reflektoj në raport me religjionet tjera.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi.

Shqyrtime të përgjithshme: Esenca e eksperiencës religjioze në Judaizëm

Literatura: Doktor Ahmed Shelebi, “*El Jehudijetu*” I, Kairo, 1986. Doktor Ahmed Shelebi, “*El Mesihijetu*” II, Kairo, 1986. Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, “*The Cultural Atlas of islam*”, New York, 1986. France Farago, “*Krishterimi, Judaizmi, Islami, dhe mendimi perëndimor*” përktheu: Bajram Muça, Lira, 1999, Tiranë. (Në vazhdim kjo literaturë do të jetë bazë e ligjërit). Ferit Zeqiri, Besimet krishtere dhe qëndrimi islam ndaj tyre, Shkup, 1432h.-2011.

Java e dytë: Periudha patriarkale

“Zoti i baballarëve tanë”

“Zoti i stërgjyshërve tanë”

“Zoti i Abrahamit”

“Zoti i Jakobit”

Bisedë interaktive mbi shkaqet e ndarjes

Literatura: Doktor Ahmed Shelebi, “*El Jehudijetu*” I, Kairo, 1986.

Java e tretë: Etnocentrizmi hebraik

Udhëheqja e Moisiut në mjedisin e tyre primordial

Përsëritje nga orët e mëparshme

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, “*The Cultural Atlas of islam*”, New York, 1986.

Java e katërt: Periudha e Moisiut

Amfiktionia apo “aleanca e shenjtë” midis fiseve

Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, “*The Cultural Atlas of islam*”, New York, 1986.

Java e pestë: Periudha davidiane

Hyrja dhe ngulimi i “popullit të përzier” në Palestinë

Niveli kulturor tek hebrenjtë

Ndërtimi i Tempullit

Literatura: Doktor Ahmed Shelebi, “*El Jehudijetu*” I, Kairo, 1986.

Java e gjashtë: Periudha ekzilike

Vizionit i ri religjioz – mesianizmi

Dëshira e vjetër mesopotamike

Koncepti i idealit etnocentrik

Literatura: “*Krishterimi, Judaizmi, Islami, dhe mendimi perëndimor*” përktheu: Bajram Muça, Lira, 1999, Tiranë.

Java e shtatë: Periudha postekzilike

Eskatologjia e mësuar në Babiloni

Kundërmasa destruktive për ta shuar Sion-in (Jerusalem)

Testi i parë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit të parë

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, “*The Cultural Atlas of islam*”, New York, 1986.

Java e tetë: Judaizmi në Arabinë gadishullore

Eksodi i tyre nga Egjipti

Fise shtegtare gjatë epokës patriarkale

Vendosja e yre në Arabinë Veriperëndimore

Bisedë interaktive mbi marrëdhëniet shiite-sunite në kohën bashkëkohore.

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, *“The Cultural Atlas of islam”*, New York, 1986.

Java e nëntë: Krishterimi

Jezusi djali i Marisë

Transcendenca hyjnore

Literatura: France Farago, *“Krishterimi, Judaizmi, Islami, dhe mendimi perëndimor”* përktheu: Bajram Muça, Lira, 1999, Tiranë.

Java e dhjetë: Riformimi i partikularizmit etnocentrik

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, *“The Cultural Atlas of islam”*, New York, 1986.

Java e njëmbëdhjetë: Esenca

Internalizimi i fesë

Debat mbi mbi rifitim e shpirtit duke iu drejtuar vetëdijes së njeriut

Literatura: Doktor Ahmed Shelebi, *“El Mesihijetu”* II, Kairo, 1986.

Java e dymbëdhjetë: Manifestimi

Shërbesa reformativ e Jezusit

Gnosticizmi- ideologjia dominonte

Helenizmi -kultura dominante

Diskutime dhe përsëritje të leksioneve nga ora e mëparshme.

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, *“The Cultural Atlas of islam”*, New York, 1986.

Java e trembëdhjetë: Kishat e krishtera

Jezusi tokësor, njerëzor, dhe historik

Bisedë interaktive për Arianizmin që ka dominuar Krishterizmin për disa shekuj.

Literatura: Doktor Ahmed Shelebi, *“El Mesihijetu”* II, Kairo, 1986.

Java e katërbëdhjetë: Krishterizmi në Arabi

Debat rreth Banorëve të krishterë të Gjysmëhënësës Pjellore Perëndimore, si edhe të krishterëve të Gadishullit

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, *“The Cultural Atlas of islam”*, New York, 1986.

Java e pesëmbëdhjetë: Kontributi i traditës Judeo-krishtere në Islam

Testi përfundimtarë, studentët ndahen në dy grupe dhe i nënshtrohen testit me shkrim.

Literatura: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, *“The Cultural Atlas of islam”*, New York, 1986.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 20%

Prezantim 20%

Provimi final 50%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Doktor Ahmed Shelebi, *“El Jehudijetu”* I, Kairo, 1986.
2. Doktor Ahmed Shelebi, *“El Mesihijetu”* II, Kairo, 1986.
3. Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, *“The Cultural Atlas of islam”*, New York, 1986.
4. France Farago, *“Krishterimi, Judaizmi, Islami, dhe mendimi perëndimor”* përktheu: Bajram Muça, Lira, 1999, Tiranë.
5. Ekrem Sarikçioğlu, *“Historia e feve*, përkth. Qani Nesimi, Logos-A, Shkup, 2007.
6. Dr. Maurice Bucaille, *Bibla, Kur’ani, dhe shkenca*, përkth. Nazim Juniku, dhe Agim Jaka, Gjakovë 1997.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Ferit Zwqiri, *“Besimet krishtere dhe qëndrimi i islamit ndaj tyre”*, Shkup, 2011
 2. Kukaj, Tahir, *“Besueshmëria e civateve Kur’anoredheatyre Biblike”*, Prishtinë, 2005.
 5. Ehrman, Bart D., *“Të keqcitosh Jezusin”*, përktheu nga angl. Rezart Beka, Tiranë, 2007.
 6. Xavier Leon –Dufour, *“Fjalor i teologjisë biblike”* përktheu: Odette Marquet, Napoli, 2009.
- Smjernice za Dijalog između Kerscana i muslimana, Zagreb, 1984.

